

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E SHËRIMIMIT / DATE OF RECEIPT: 7-07-2025			
Njesia Org. / Org. Unit: 03	Shif. klasif. / Klasif. Kod: 47	Nr. Prot. / Br. Prot.: 1184	Nr. faqeve / Br. Stranica: 7



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA / GOVERNMENT MINISTERIA E EKONOMISE / MINISTRY OF ECONOMY			
Njesia Org. / Org. Unit: 01	Nr. Prot. / Br. Prot.: 3561	Nr. i faqeve / Broj stranica: 6	Data / Datum: 04.07.25
PRISHTINE / NO. 1			

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria
 Vlada-Government
 Ministria e Ekonomisë
 Ministarstvo Ekonomije/Ministry of Economy

REFERENCË:	PLANI I VEPRIMIT		
PËR/ZA/TO:	znj.Vlora Spanca -Auditore e Përgjithshme/ Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës		
CC:	Znj.Leonita Shabani Mullarama, zv.Sekretare/ Ministria e Ekonomisë		
NGA/OD/FROM:	Artane Rizvanolli, Ministre në detyrë/ Ministria e Ekonomisë		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimit		
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	
Br. kancelarije:		Kucni:	ME - PRISHTINË
Room No.:		Extension:	
		Data:	03.07.2025
		Datum:	
		Date:	



E nderuara Auditore e Përgjithshme znj. Spanca,

Bazuar në raportin e Auditimit me numër protokolli 2385 të datës 09.06.2025 për pasqyrat Financiar Vjetore të Ministrisë së Ekonomisë për vitin 2024 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ju lutem gjeni të bashkëlidhur Raportin për implementimin e Planit të Veprimit të Menaxhmentit për zbatim të rekomandimeve.

Me respekt,

Viti: 2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

Emri i Auditimit:

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË
MINISTRISË SË EKONOMISË PËR VITIN 2024

Plani i Veprimit të Menaxhmentit për zbatim të rekomandimeve

Për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit për Pasqyrat Fianciare që perfundojnë me 31 Dhjetor 2024

Opinion i Auditimit

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Nr	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar për përfundim	Personi përgjegjës	Zbatuar PO/JO	Në proces	Komentet
<p>Cështja A1 Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve</p>	<p>Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj që janë marrë veprime konkrete në koordinim edhe me Ministrinë e Financave në menyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjen adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>Sipas Ligjit për zyrtarët publik do të ndërmerren masa për shkelje administrative. Në kuadër të marrëveshjeve të projekteve nga huamarrja dhe manualit të operimeve përgjegjësia për udhëheqjen e projektit do të përcaktohet në nivel të ZKA-së.</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>ZKA ZKF</p>			
<p>Cështja B1 Mangësi në regjistrimin e pasurive</p>	<p>Rekomandimi B1 Ministrja duhet të siguroj regjistrimin e plotë dhe të saktë të pasurisë si dhe azhurnimin e regjistrave me qëllim që shpalosja në PFV të jenë të sakta dhe të prezantojnë pamje të</p>	<p>Rishikimi dhe korrigjimi i regjistrave të pasurive: Sigurimi i regjistrimit të plotë dhe të saktë të pasurive në sistemet përkatëse sipas rregullores MF nr. 02/2013.Korrigjimi i gabimeve në klasifikim</p>	<p>Tetor 2025</p>	<p>Departamenti Buxhet dhe Finanacev-Divizioni për Buxhet dhe Planifikim</p>			

	<p>drejtë. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evenidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.</p>	<p>dhe përjashtimi i shpenzimeve operative nga vlera e pasurive.</p> <p>Forcimi i kontrolleve të brendshme Vendosja dhe përforcimi i procedurave për regjistrimin, azhurimin dhe kontrollin e pasurive.</p> <p>Trajnimi dhe përgatitja e stafit përgjegjës për menaxhimin e pasurive Sigurimi i trajnimeve për personelin përgjegjës.</p> <p>Përforcimi i kapaciteteve për të parandaluar gabimet në regjistrim.</p> <p>Monitorimi dhe raportimi Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të regjistrimit dhe raportimit të pasurive.</p>				
<p>Cështja A2 Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontigjente</p>	<p>Rekomandimi C1 Ministrja duhet të siguroj një kontroll dhe koordinim me efektiv në mes zyrës ligjore dhe avokaturës shtetërore me qëllim që regjistrat e</p>	<p>Në përputhje të plotë me rekomandimin përkatës, Zyra Ligjore e Ministrisë së Ekonomisë do të vijojë mbajtjen e një regjistri të detajuar, në koordinim të ngushtë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me</p>	Në vijimësi	Departamenti Ligjor		

	detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informata, dhe që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Avokaturën Shtetërore.”					
<u>Çështja A3</u> Vonesë në procesin e vlerësimit të tenderëve	<u>Rekomandimi A3</u> Ministrja duhet të siguroj që themelimi i komisionit të vlerësimit e ofertave të bëhet me kohë, në mënyrë që procesi i vlerësimit të përfundoj brenda afateve të përcaktuara. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse, duhet të shtohen resurset e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit dhe për të shmangur vonesat në nënshkrim të kontratave.	Me qëllim të evitimit të vonesave në procesin e vlerësimit të tenderëve ZKA përmes Vendimeve për emërimin e Komisioneve dhe grupeve punuese ka përcaktuar se Komisioni duhet të përfundoj këtë proces brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.	Në vijimësi	Komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit.			

<p>Cështja A3 – Mos permbushja e planit vjetor të auditimit të brendshëm</p>	<p>Ministrja duhet të siguroj se NJAB vepron në mënyrë efektive, në mënyrë që t'i shtoj vlerë përmirësimit të aktiviteteve operative dhe cilësisë së kontrolleve të brendshme aktuale. Po ashtu, duhet të permbushen objektivat duke mbuluar fushat e përcaktuara në planin vjetor të auditimit.</p>	<p>Sipas Ligjit për zyrtarët publik do të ndërmarrën masa disiplinore sipas përgjegjësisë.</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>Minsitrja ZKA</p>			
---	--	--	--------------------	--------------------------	--	--	--

Menaxheri i aktivitetit / procesit të audituar:

Data: 03.07.2025

